

AKT I THEMELIMIT
I SHOQERISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
"BALAJ" SH.P.K

Sot, më 31/10/2024, në Tiranë, palët e mëposhtme (referuar në tekst kolektivisht si "**Ortaku Themelues**", ose individualisht secili si "**Ortaku**") bien dakord të miratojnë Aktin e Themelimit, si më poshtë :

1. **Drilona Balaj**, shtetase shqiptare, lindur në Tirane, më 04.01.1990, mbajtëse e Letërnjoftimit nr. 039196175, me nr. Personal J05104005F.

I. Themelimi

1. Ortaku themelues vendos për themelimin e shoqërisë " **BALAJ** " Sh.p.k, nje shoqëri shqiptare me përgjegjësi të kufizuar ("**Shoqëria**").
2. Zyrat qendrore të Shoqërisë ndodhen në adresën : Njësia bashkiake nr 5, rruga Medar Shtylla, kompleksi Kika 2, pallati nr 6, kati 1, Tiranë, Shqipëri.
3. Shoqëria është themeluar për një kohëzgjatje të pacaktuar.

II. Objekti

1. Objekti i veprimtarisë së Shoqërisë është si më poshtë:
 - Parukeri
 - Kurse të formimit profesional
 - Sipas legjislacionit ne fuqi, shoqeria ne menyre qe te arrije objektivat e saj mund te kryeje aktivitete te konsideruara te dobishme apo te nevojshme per te arritur qellimet e shoqerise.
2. Shoqëria do të kryejë çdo veprimtari që bën pjesë në objektin e saj, që lidhet me të dhe që e mbështet atë.
3. Shoqeria zbaton të gjitha ligjet dhe aktet nënligjore të duhura. Ajo zbaton standardet më të larta të etikës.

III. Statuti

Ortaku Themelues me anë të kësaj deklaron miratimin e Statutit të Shoqërisë .

IV. Kapitali Themeltar



1. Kapitali fillestar i Shoqërisë është 10,000 (dhjetë mijë) Lekë. Ortaku zotëron 1 (një) kuotë me një vlerë të përgjithshme nominale në proporcion me kontributin e ortakut në kapitalin e Shoqërisë

Ortaku zotëron kapitalin si më poshtë:

- **Drilona Balaj** – 100 % 10,000 (dhjetë mijë) Lekë

2. Kuotat janë të zakonshme dhe secili ortak ka të drejta votimi *proporcionale* me vlerën nominale të çdo kuote.
3. Kapitali i Shoqërisë paguhet plotësisht dhe nënshkruhet nga Ortaku Themelues.

V. Administratori

1. Shoqëria menaxhohet nga 1 (një) Administrator i cili është përfaqësuesi ligjor i Shoqërisë dhe e përfaqëson atë te çdo pale e tretë. Numri i Administratorëve mund të ndryshohet nga Asambleja e Përgjithshme.
2. Administratori do të jetë përgjegjës për punët e përditshme të Shoqërisë, duke iu nënshtruar kufizimeve të parashikuara në Statut, ligjin e aplikueshëm dhe nga Asambleja e Përgjithshme.
3. Administratori emërohet për një mandat 5 (pesë) vjeçar dhe mund të riemërohet. Administratori i parë i Shoqërisë është:

- **Drilona Balaj, shtetase shqiptare, , lindur në Tiranë, më 04.01.1990, mbajtës i Letërnjoftimit nr. 039196175, me nr. Personal J05104005F.**

Akti i Themelimit është hartuar në 3 (tre) kopje origjinale në gjuhën shqipe. Akti i Themelimit është hartuar në pajtim me Ligjin Nr . 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar.

Ortaku

Drilona Balaj



STATUT I SHOQERISE

“BALAJ” SH.P.K.

Ky Statut do të konsiderohet se inkorporon dhe/ose përfshin Aktin e Themelimit të Shoqërisë organizimi dhe funksionimi i të cilës rregullohet këtu.

Sot, me 31/10/2024, në Tiranë, ortaku i mëposhtëm:

Znj. Drilona Balaj, shtetase shqiptare, lindur në Tiranë, më 04.01.1990, mbajtës i Letërnjoftimit nr. 039196175, me nr. Personal J05104005F, madhore e me zotësi të plotë juridike e për të vepruar;

ne përputhje me Ligjin Nr.9901, datë 14.04.2008, “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” dhe me legjislacionin e zbatueshëm në Republikën e Shqipërisë, miratuan këtë Statut si vijon:

Në këtë statut

- “Ligji” është Ligji 9901/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë tregtare”, i ndryshuar;
- “Statuti” është ky Statut i Shoqërisë;

Kreu I

Themelimi, Emri, Objekti, Kohëzgjatja, Selia

Neni 1

Data e Themelimit, Emri dhe Themeluesit

Sot, më 31/10/2024, themeluesit e mësipërm, vendosëm të krijojmë një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me emrin dhe emërtimin tregtar **“BALAJ” SH.P.K.**

Neni 2

Objekti

Shoqëria do të kryejë aktivitetin e mëposhtëm:

- Parukeri
- Kurse të formimit profesional

Sipas legjislacionit në fuqi, shoqëria në mënyrë që të arrijë objektivat e saj mund të kryejë aktivitete të konsideruara të dobishme apo të nevojshme për të arritur qëllimet e shoqërisë.

Neni 3

Kohëzgjatja

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë e ***pacaktuar dhe/ose e pakufizuar***.

Neni 4

Selia

- I. Selia e shoqërisë ndodhet në adresën: **Njesia bashkiake nr 5, rruga Medar Shtylla, kompleksi Kika 2, pallati nr 6, kati 1, Tiranë, Shqipëri.**

Me vendim të Administratorit, Shoqëria mund të hapë degë dhe/ose zyra përfaqësimi brenda ose jashtë Republikës së Shqipërisë.

Kreu II

Kapitali

Neni 5

Kapitali themeltar

Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë është **ALL 10,000 (dhjetë mijë lekë)** dhe zotërohet në masën 100% nga **Drilona Balaj**, zotërues i **1 (një) kuote** me vlerë të përgjithshme **10,000 (dhjetë mijë lekë)**

Kontributi i ortakut është në para.

Neni 6

Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit

Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet nëpërmjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë, nëpërmjet emërimit nga gjykata kompetente e një eksperti të autorizuar për këto kontribute sipas kërkesës së administratorit. Në asnjë rast shumica nuk mund të detyrojë një ortak për të rritur angazhimin e tij në kapitalin



themeltar të shoqërisë.

Zvogëlimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakëve, e cila merr vendim në të njëjtat kushte që kërkohen për ndryshimin e statutit.

Në të gjitha rastet zvogëlimi i prek ortakët në të njëjtën masë ndaj pjesëve të kapitalit që përfaqësojnë.

Neni 7

Transferimi i kapitalit

Kuotat e kapitalit e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet: kontributit në kapitalin e shoqërisë; shitblerjes; trashëgimisë; dhurimit; çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

Çdo disponim në favor të një pale të tretë nëpërmjet veprimeve juridike ndërmjet të gjallëve duhet të bëhet në formë noteriale dhe të regjistrohet. Në rastet e transferimit të pjesëve të kapitalit me kundërshtpërblim, ortakët e tjerë kanë të drejtën e parablerjes.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve, për sa nuk parashikohet ndryshe në statut. Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

KREU III

ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE

Neni 8

Organi Vendimmarrës



Asambleja e Ortakeve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë.

Asambleja e Ortakeve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë që miraton çdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj.

Asambleja e përgjithshme e ortakeve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- ç) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat “c” dhe “ç” të kësaj pike;
- dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecursisë së veprimtarisë;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecursisë së veprimtarisë; ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- i) shpërndarjen e fitimeve vjetore;
- j) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë.

Administratori i shoqërisë nuk mund të veprojnë si përfaqësues i ortakeve në asamblenë e përgjithshme.

Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

Per sa kohe që kapitali themeltar i Shoqërisë zotërohet nga një ortak i vetëm, ky i fundit do të ushtrojë kompetencat e Asamblese së Përgjithshme të Ortakeve.

Neni 9

Mënyra e Thirrjes së Mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme

Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose, nëse parashikohet nga statuti, me njoftim nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t’u dërgohet të gjithë ortakeve, jo më vonë se 7 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.

Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur sipas pikës 1 të këtij neni, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord, për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.

Neni 10

Kuorumi



Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 30 për qind të kuotave.

Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar sipas nenit 87 të ligjit “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm, nëse ortakët që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave, janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të këtij ligji.

Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur me lart, asambleja mbledhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

Neni 11

Marrja e vendimeve

Asambleja e përgjithshme vendos me tri të katërtat e votave të zotëruesve të kapitalit, të ortakëve pjesëmarrës, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës, për çështje të tjera si: përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë; emërimin e administratorëve; emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar; përcaktimin e shpërblimeve; mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecursisë së veprimtarisë; përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet etjera ndaj administratorëve; miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë.

Neni 12

Përjashtimi nga e drejta e votës

Ortaku nuk mund të ushtrojë të drejtën e votës nëse asambleja e përgjithshme merr vendim për: vlerësimin e veprimtarisë së tij; shuarjen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij; ngritjen e një padie ndaj tij nga shoqëria; dhënien ose jo të përfitimeve të reja.

Kur ortaku përfaqësohet nga një përfaqësues i autorizuar, i autorizuari vlerësohet të jetë në të njëjtin konflikt interesi, ashtu si dhe ortaku, të cilin përfaqëson.

Neni 13

Administrimi



Asambleja e përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizikë si administratorë të shoqërisë. Afati i emërimit është 5 vjet me të drejtë ripërtëritjeje. Emërimi i administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

Personi i mëposhtëm caktohet si Administrator i parë i shoqërisë për një mandat 5 (pesë) vjeçar emërimi:

Znj. **Drilona Balaj**, shtetase shqiptare, lindur në Tiranë, më 04.01.1990, mbajtëse e Letërnjoftimit nr. 039196175, me nr. Personal J05104005F; madhore e me zotësi të plotë për të vepruar.

Kreu IV

Viti financiar-ekspertet

Neni 14

Viti Financiar

Viti financiar i Shoqërisë fillon me 1 Janar dhe përfundon me 31 Dhjetor. Përgjashtimisht, viti i parë financiar fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe mbyllet me 31 Dhjetor.

Neni 15

Ekspertet

Ekspteri ka për detyrë që të kontrollojë të gjithë dokumentacionin kontabël të veprimtarisë ekonomike tregtare të shoqërisë, atë gjithëvjetor dhe atë në lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij për rastet kur ai është ngarkuar dhe ka kryer një gjë të tillë i ngarkuar nga ana e ortakeve. Në përfundim të kontrollit ekspertit kontabël i autorizuar përgatit raportin me shkrim për nxjerrjen e rezultatit të bilancit financiar vjetor si dhe për atë për kontrollet periodike të ushtruara, të cilat është i detyruar që t'ia paraqesë e dorëzojë në kohë ortakeve për t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazën e të drejtës vendimore që ka.

Kreu V

Prishja – Riorganizimi i Shoqërisë

Neni 16

Prishja dhe likuidimi



Shpërndarja ose prishja e shoqërisë mund të behet në çdo kohë: kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj; me vendim të Asamblesë së Ortakëve; me hapjen e procedurave të falimentimit; në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit 9723/2007; me vendim të gjykatës.

Në këtë rast Ortaket marrin vendim me shkrim në të cilin parashikojnë mënyrën e likuidimit të shoqërisë, duke caktuar 1 apo disa likuidatorë dhe shënuar në çdo dokument të nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emërtesën shtesë “Shoqëri në likuidim e sipër”.

Prishja e shoqërive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftës isë paguese, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi.

Likuidimi kryhet nga likuiduesit që janë emëruar nga Ortaket.

Nëse Ortaket nuk marrin një vendim për emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t’i drejtohet gjykatës, për të caktuar një likuidues.

Neni 17

Riorganizimi i shoqërisë bashkimi-ndarja

Shoqëria mund të ndahet, bashkohet sipas Vendimit të Mbledhjes së Përgjithshme të Asamblesë së Ortakëve, në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në Pjesën IX të Ligjit 9901 datë 14.04.2012 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”.

Neni 18

Baza Ligjore

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e tij në përputhje të plotë me këtë statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Për sa nuk parashikohet në këtë statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, Kodit Civil dhe çfarëdo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.

Neni 19

Mosmarrëveshjet

Për mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij statuti, si dhe për çdo mosmarrëveshje që mund të lindë midis Shoqërisë dhe të tretëve, do të jetë kompetente Gjykata Shqiptare.



Ky akt u hartua ne gjuhen Shqipe dhe pasi u lexua, u kuptua dhe u nënshkrua nga ortakët themelues si vijon:

ORTAKËT

E SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

“BALAJ” SH.P.K

Drilon Balaj

A handwritten signature in blue ink, appearing to be 'Drilon Balaj', written below the printed name.